



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASENIT UJOR DRIN-BUNË

Nr. 30 prot
Dt. 29/06/2022



VENDIM

Nr.23, datë 22.06.2022

PËR

**MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM BURIMI UJOR
NËNTOKËSOR PËR QËLLIME INDUSTRIALE,
SHOQËRISË "G & S"**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre", me propozimin e Agjencisë së

Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime industriale subjektit "G & S", me vendndodhje, Fshati Renc, Gur i Zi, Shkodër sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujor (Fshati Renc, Gur i Zi, Shkodër)

Vepra e marrjes, koordinatat në KRGJSH

- X= 463212
- Y= 4658579
- Z= 18 m.m.n.d

Pika e shkarkimit, koordinatat në KRGJSH

- X= 463236
- Y= 4658607
- Z= 18 m.m.n.d

- $Q_{mes}=1.01$ l/s
- $Q_{llog}=1.01$ l/s
- Qeko: nuk ka

3. Zbatimi i lejes nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBU DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

